




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 39 paragrafi 1.4, në nenin 46 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 11.03.2015 miratoi këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2013 dhe 2014, në vitin fiskal 2015

1. Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2013 dhe 2014 në vitin fiskal 2015.
2. Mjetet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2013 dhe 2014, në vitin fiskal 2015 barten sipas tabelës e cila është e bashkangjitur këtij.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 016-26445
Gjilan, 11.03.2015

Kryesuesja e kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi